



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:062328

Datë: 02.08.2023

Numri i dokumentit: 04547567

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.M. nga fshati, Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2449-3/17 e datës 30.11.2017, jashtë seancës, në bazë të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 lidhur me nenin 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, datë 02.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2449-3/17 e datës 30.11.2017, PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit D.M. nga i ati Blerim, i lindur më datë ..., me numër personal, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, për shkak se lidhur me këtë vepër penale ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale..
- II. E dëmtuara KEDS – Distrikti Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.
- III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 30.11.2017, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2449-3/17, kundër të pandehurit D.M. për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Me datë 30.08.2018, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën i pandehuri D.M. ka munguar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Më datë 04.12.2018, ndaj të pandehurit D.M. është lëshuar urdhërrarrest. Më datë 20.12.2018, Stacioni policor në Ferizaj përmes memorandumit zyrtar e ka njoftuar gjykatës se i pandehuri D.M. gjendet në shtetin e Zvicrës. Më datë 25.01.2019, ndaj të pandehurit D.M. është lëshuar urdhërrarrest. Më datë 04.02.2021, ndaj të pandehurit D.M. është lëshuar Letërreshtim. Më datë 07.03.2022, ndaj të pandehurit D.M. është lëshuar Letërreshtim. Më datë 18.07.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, mirëpo i pandehuri D.M. nuk ka prezantuar në seancë, në shkresat e lëndës nuk ka prova se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt.

2.Parashkrimi i veprës penale

Neni 321 i KPRK-së lidhur me veprën penale Lidhja e paautorizuar në shërbime përcakton se: *“Kushdo që lidhet apo rilidhet në përçues të rrymës apo në rrjetin për përçim ose shpërndarje të çfarëdo shërbimi komunal në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt apo tërthorazi, qoftë përmes përçueshmërisë ose induksionit, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.*

Neni 106 i KPRK-së përcakton se: *“Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme: 1.5. tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”.*

Neni 107 paragrafi 8 i KPRK-së përcakton se: *“Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit”.*

Andaj, duke pasur parasysh se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është kryer më datë 20 korrik 2017, dhe e njëjta është e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga kjo datë – data e kryerjes së veprës penale. Sipas dispozitës së nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 parashkrimi lidhur me këtë vepër penale është 3 vjet nga kryerja e veprës penale, gjithashtu neni 107 paragrafi 8 i KPRK-së përcakton se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, e në rastin konkret dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit është 6 vite, andaj nga data 20 korrik 2017 e deri

në datën e sotme 02 gusht 2023, kanë kaluar më tepër se 6 vite, dhe kjo vepër penale është përfshi në parashkrim absolut. Parashkrimi absolut i ndjekjes penale paraqitet kur kalon dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin, pa marrë parasysh në ndërprerjet apo ndaljet eventuale të mëparshme.

3. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 3 i KPP-së, përcakton se: “*Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente*”. Andaj, pasi që është pushuar procedura penale ndaj të pandehurit, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

4.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Neni 453 paragrafi 1 i KPP-së, përcakton se: “*Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni*”. Andaj, pasi që është pushuar procedura penale ndaj të pandehurit, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore u vendos si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr. 3031/2017, me datë 02.08.2023

Zyrtarja Ligjore,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.